



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

**KURRIKULA PËR SHKOLLAT ME DREJTIM
TË ORIENTUAR ARTISTIK**

ARSIMI I MESËM I LARTË

DEGA: KOREOGRAFI

LËNDA: GJUHË SHQIPE

KLASA: X

Tiranë, 2016



HYRJE

Lënda e gjuhës shqipe bën pjesë në fushën “Gjuhët dhe komunikimi”. Në arsimin e mesëm të lartë, kjo fushë përbëhet nga lëndët: Gjuhë shqipe, Letërsi, Gjuhë e huaj e parë dhe Gjuhë e huaj e dytë. Të gjitha lëndët e kësaj fushe synojnë zhvillimin gjuhësor e letrar që është boshti themelor për rritjen intelektuale, shoqërore, estetike dhe emocionale të nxënësve. Më konkretisht, fusha “Gjuhët dhe komunikimi” i aftëson nxënësit që ta përdorin gjuhën për të komunikuar, për të plotësuar interesat e tyre personale, për kënaqësi estetike, për të marrë informacion, si dhe për të përmbushur kërkesat e shoqërisë dhe të vendit të punës.

Lënda e gjuhës shqipe ka një rëndësi të veçantë në kurrikulën e arsimit të mesëm të lartë. Njëpërmjet kësaj lënde, nxënësit:

- fitojnë njohuri dhe demonstrojnë shkathtësi, vlera dhe qëndrime rreth sistemit gjuhësor të shqipes;
- fitojnë njohuri dhe demonstrojnë shkathtësi, vlera dhe qëndrime për të komunikuar në mënyrën e duhur (të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit dhe të shkruarit).

Lënda e gjuhës shqipe, gjithashtu, siguron mundësi që nxënësit të ndiejnë fuqinë e gjuhës si një mënyrë për të shprehur përvojat e tyre dhe për të shmangur vështirësitë që ndajnë individët. Nxënësit, gjatë zhvillimit të kësaj lënde, ndërtojnë dhe zhvillojnë kompetencat gjuhësore, në mënyrë që të bëhen anëtarë kritikë dhe aktivë në shoqëri. Duke u mbështetur në studimin e teksteve të llojeve dhe tematikave të ndryshme, programi nxit vlerësimin e trashëgimisë së pasur kulturore dhe letrare. Njëpërmjet këtyre teksteve, nxënësit dallojnë dhe vlerësojnë jo vetëm strukturën dhe karakteristikat e vetë teksteve, por edhe mesazhet dhe kuptimet e tyre.

Gjuha shqipe, si çdo lëndë tjetër, mundëson zotërimin e kompetencave kyçe, të përcaktuara në kornizën kurrikulare. Këto kompetenca janë të domosdoshme për një individ, i cili duhet të përmbushë me sukses kërkesat personale, shoqërore dhe profesionale. Këtë “mision” lënda e realizon njëpërmjet ndërtimit dhe zhvillimit të kompetencave të saj. Duke u bazuar në synimet dhe specifikat e lëndës, pesë kompetencat e saj janë:

- Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar.
- Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme.
- Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale.
- Të lexuarit e teksteve të ndryshme
- Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit.

Puna për ndërtimin e kompetencave kyçe dhe të kompetencave lëndore ka nisur që në arsimin bazë. Në këtë cikël arsimit, nxënësit janë pajisur me njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet e domosdoshme për jetën dhe për tregun e punës. Mirëpo kompetenca zhvillohet dhe përsoset gjatë gjithë jetës dhe nuk ka pikëmbërritje. Në arsimin e mesëm të lartë, nxënësit përballen me sfida të reja. P.sh., nga kontekste familjare dhe informale (me shokët e shoqet e klasës dhe me mësuesit), nxënësit tani do të flasin e do të diskutojnë në kontekste më formale (në një debat në shkollë, në aktivitete me mësues, në veprimtari të ndryshme) dhe do të ushtrohen edhe për të folurit në publik.

Programi i gjuhës shqipe bazohet në parimin e integritit të njohurive dhe në parimin e rimarrjes së tyre, vit pas viti, duke i zgjeruar dhe duke i thelluar ato.

I. KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT TË GJUHËS SHQIPE

Hartimi i programit lëndor mbështetet në kornizën kurrikulare të arsimit parauniversitar dhe në planet mësimore të shkollave artistike dhe sportive.

Përdoruesit e programit janë mësuesit, autorët e teksteve, prindërit dhe komuniteti, specialistët e arsimit dhe fakultetet e mësuesisë.

Mësuesit do ta përdorin programin e gjuhës shqipe për të krijuar një tablo të qartë rreth asaj se çfarë duhet të dinë dhe të jenë të aftë të bëjnë nxënësit dhe se si duhet ta ndërtojnë mësimdhënien për të pajisur nxënësit me kompetencat kyçe dhe të lëndës, si dhe për të përmbushur kërkesat e programit.

Autorët e teksteve do ta përdorin programin e gjuhës shqipe për të hartuar tekste shkollore në funksion të realizimit të tij. Leximi i kujdesshëm i programit për çdo shkallë dhe për çdo klasë do t'i ndihmojë ata për të siguruar lidhjen logjike dhe për të shmangur mbingarkesën.

Prindërit dhe komuniteti, nëpërmjet programit, mund të informohen për njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet që duhet të zotërojnë fëmijët e tyre në lëndën e gjuhës shqipe.

Specialistët e arsimit mund ta përdorin programin e gjuhës shqipe për qëllime inspektimi, monitorimi, vlerësimi, studimi etj.


Fakultetet e mësuesisë mund ta përdorin programin lëndor për të përshtatur kurrikulat e tyre, me qëllim përgatitjen efektive të mësuesve të ardhshëm, si dhe për praktikën pedagogjike të studentëve.

Programi i gjuhës shqipe ka në fokus realizimin e kompetencave kyçe dhe të kompetencave të lëndës, gjatë punës për përmbushjen e të cilave do të realizohen temat ndërkurrikulare të cilat mundësojnë lidhjen e lëndës me jetën e përditshme, shoqërinë dhe tregun e punës.

Në program, gjithashtu, përshkruhet lidhja e gjuhës shqipe me fushat dhe lëndët e tjera, në mënyrë që formimi i nxënësit të jetë tërësor e jo fragmentar.

Në program janë përcaktuar njohuritë, aftësitë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet për çdo kompetencë të lëndës, të klasifikuara sipas disa tematikave. Po kështu, në program janë dhënë sugjerime edhe për shpërndarjen e orëve mësimore.

Diagrami i mëposhtëm paraqet organizimin e programit.



1. Qëllimet e arsimit parauniversitar

Arsimi parauniversitar krijon kushte dhe mundësi që nxënësit: të ndërtojnë dhe të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike; të zhvillohen në mënyrë të pavarur e të gjithanshme; të kontribuojnë në ndërtimin dhe në mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë shqiptare, si dhe të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.

Në arsimin parauniversitar, nxënësit:

- kultivojnë identitetin vetjak, kombëtar dhe përkatësinë kulturore;
- përvetësojnë vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare;
- zhvillohen në aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike;
- zhvillojnë përgjegjësi ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;
- aftësohen për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
- aftësohen për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- zhvillojnë shpirtin e sipërmarrjes;
- përdorin teknologjitë e reja.

2. Qëllimet e lëndës së gjuhës shqipe

Në përfundim të arsimit të mesëm, në lëndën e gjuhës shqipe, nxënësit:

- përforcojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre për gjuhën dhe komunikimin;
- pasurojnë fjalorin e tyre, fitojnë njohuri gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit, si dhe zbatojnë rregullat e gjuhës së folur dhe të shkruar;
- shkruajnë qartë, saktë e në mënyrë logjike dhe përshtatin gjuhën dhe stilin e tyre në varësi të qëllimit, kontekstit dhe audiencës;
- krijojnë marrëdhënie të qëndrueshme me leximin, nëpërmjet të cilit fitojnë kënaqësi dhe informacion;
- përdorin diskutimin dhe ndërveprojnë me të tjerët, me qëllim që të komunikojnë, të mësojnë të shprehin qartë dhe të argumentojnë mendimet dhe idetë e tyre;
- zotërojnë “artin” e të folurit dhe të dëgjuarit, bëjnë prezantime formale dhe marrin pjesë në diskutime dhe në debate të ndryshme duke dhënë kontributin e tyre;
- përvetësojnë aftësitë e duhura për të analizuar, për të interpretuar, për të vlerësuar dhe për të prodhuar tekste për një larmi funksionesh;

- zbatojnë njohuritë dhe strategjitë e procesit të të lexuarit për t'u bërë lexues të pavarur, si dhe për të kuptuar dhe për të gjykuar tekste dhe materiale të llojeve të ndryshme;
- interpretojnë dhe vlerësojnë informacione të ndryshme për botën në përgjithësi.

3. Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës

Një nga synimet kryesore të arsimit është që të krijojë qytetarë që janë të aftë të bëjnë gjëra të reja, që janë krijues dhe zbulues. Arsimi, gjithashtu, formon dhe zhvillon mendje kritike të cilat gjykojnë, verifikojnë dhe nuk pranojnë çdo gjë që u jepet. Për t'i përgatitur këta qytetarë, në kornizën kurrikulare janë përcaktuar kompetencat kyçe, si të domosdoshme për një individ, me qëllim që ai të jetë i suksesshëm një jetën personale, shoqërore dhe profesionale. Këto kompetenca duhen ndërtuar dhe duhen zhvilluar gjatë gjithë procesit mësimor.


Realizimi i kompetencave kyçe gjatë procesit të mësimdhënies dhe të nxënies kërkon që mësuesi të lidhë kompetencat e lëndës me kompetencat kyçe për secilën shkallë. Për ta realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë metodat, teknikat dhe mjetet e përshtatshme didaktike për realizimin e çdo kompetence dhe rezultati të të nxënit. Kur nxënësi përmbush kompetencat e lëndës së gjuhës shqipe, ai, njëkohësisht, zhvillon edhe kompetencat kyçe. P.sh., gjatë një prezantimi, nxënësi përdor edhe mjetet e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit dhe realizon, kështu, edhe kompetencën digjitale. Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës pasqyrojnë të njëjtën qasje me rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe në këndvështrimin e domosdoshmërisë së tyre në jetë, në shoqëri dhe në punë.

Më konkretisht, për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës, mësuesi ndjek këta hapa:

- përzgjedh rezultatin/et e të nxënit për kompetencat kyçe që synon të arrijë nxënësi në shkallën përkatëse;
- përcakton rezultatin e të nxënit të kompetencave kyçe për vit mësimor duke zbërthyer rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe për shkallë mësimore (janë përcaktuar në program);
- përzgjedh përmbajtjen/et mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënit;

- planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t'i arrijë rezultatet e të nxënësve brenda vitit mësimor;
- kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave e projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënësve për vit mësimor dhe për shkallë për lëndën e gjuhës shqipe.

Diagrami i mëposhtëm konkretizon lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës.



4. Rezultatet kryesore të të nxënit, sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së gjuhës shqipe gjatë shkallës së pestë dhe shkallës së gjashtë.

Në kurrikulën bërthamë janë përcaktuar rezultatet e të nxënit për çdo kompetencë kyçe. Këto rezultate realizohen nëpërmjet fushave të të nxënit dhe lëndëve mësimore. Natyrisht, secila fushë dhe lëndë mund të kontribuojë në disa rezultate të nxëni. Fusha “Gjuhët dhe komunikimi”, ku bën pjesë edhe lënda e gjuhës shqipe, ndihmon realizimin e të gjitha kompetencave, por më së shumti në kompetencën e komunikimit dhe të shprehurit. Tabela e mëposhtme paraqet rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së gjuhës shqipe gjatë shkallës së pestë dhe shkallës së gjashtë.

Shkalla V	Shkalla VI
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit <i>Nxënësi komunikon në mënyrë efektive.</i>	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shprehet, përmes një forme komunikimi, për një temë të caktuar në një material (prezantim) prej 200 fjalësh dhe veçon çështjet kryesore të ngritura në atë material; - diskuton në grup, në mënyrë konstruktive, në kohëzgjatje jo më shumë se 10 minuta, duke dhënë dhe duke marrë informacion për një temë të caktuar nga fushat e të nxënit ose nga jeta e përditshme; - lexon rrjedhshëm një tekst të përbërë prej 3-5 paragrafësh, u përgjigjet pyetjeve të shtruar për llojin e tekstit dhe stilet e të shkruarit, tregon qëllimin dhe lidhjen ndërmjet përmbajtjes së paragrafëve; - përdor drejt strukturën dhe rregullat e drejtshkrimit të gjuhës në kontekste dhe forma të ndryshme të shkrimit, si: ese, <i>e-mail</i> (postë elektronike), letër formale dhe joformale etj.; - shkruan një tekst për një temë nga jeta e përditshme, me 3-5 paragrafë, duke respektuar strukturën, drejtshkrimin dhe elementet e tjera, pastaj e prezanton para të 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shpreh, para një audience të caktuar mësimore, çështjet kryesore të ngritura në një fjalim ose interpretim të dëgjuar për një temë të caktuar nga fusha të ndryshme, përmes, së paku, një forme të komunikimit (gjuhës, simboleve, shenjave, kodeve, performancës artistike) etj.; - diskuton në grup, në mënyrë konstruktive, duke dhënë informacion e argumente dhe duke shtruar pyetje në një dialog në kohëzgjatje prej disa minutash, për një temë të caktuar; - lexon rrjedhshëm një tekst, i cili përmban 2-3 faqe (p.sh., tregim, tekst argëtues, artikull gazete ose reviste etj.); - përdor drejt strukturën dhe rregullat e drejtshkrimit të gjuhës amtare dhe të gjuhës së huaj në një numër të caktuar të konteksteve, si: ese, <i>e-mail</i>, letër formale dhe joformale etj.; - lexon rrjedhshëm një tekst të përbërë prej disa paragrafëve dhe shprehet në forma të ndryshme të komunikimit për organizimin, qëllimin e leksikun e përdorur dhe

<p>tjerëve me shqiptim të drejtë;</p> <ul style="list-style-type: none"> - shkruan një ese, jo më shumë se dy faqe, për vlerat estetike të pjesëve të caktuara artistike (poezi, prozë, pjesë muzikore, pjesë arti, vallëzim etj.), duke respektuar organizimin dhe hapat e shkrimit të një eseje; - prezanton një projekt artistik, humanitar, eksperimentues etj.) nga fusha të ndryshme mësimore, të hartuar individualisht dhe në grup, për një temë të caktuar, duke përdorur në mënyrë efektive, teknologjinë e informacionit dhe teknologji të tjera; - përdor TIK-un në mënyrë efektive gjatë komunikimit dhe ndërveprimit me të tjerët në jetën e përditshme, duke përfshirë edhe të nxëniet e informacioneve të reja dhe kryerjen e detyrave shkollore. 	<p>argumenton mesazhin që bart secili paragraf (teksti mund të jetë narrativ, përshkruar etj.);</p> <ul style="list-style-type: none"> - prezanton një temë të caktuar nga arti, nga shkenca, nga jeta e përditshme dhe, në mënyrë efektive, komunikon me audiencën, duke përdorur TIK-un dhe mediat e tjera të shkruara dhe elektronike; - shpreh mendimin e lirë, opinionin dhe qëndrimin për një temë të caktuar nga jeta, nga shkenca, nga profesioni, nga shoqëria, nga mjedisi, duke përdorur forma të ndryshme të komunikimit me gojë e me shkrim, të artit pamor, muzikor, skenik, krijimin letrar etj.; - angazhohet dhe kontribuon në një diskutim me të tjerët për një temë të caktuar, si p.sh., për edukimin mediatik, duke paraqitur argumente të bazuara në fakte për rolin dhe ndikimin e televizionit, radios, shtypit dhe mjeteve të tjera të informacionit në shoqëri, në procesin e përgatitjes së të rinjve për jetë të pavarur dhe orientim në karrierë; - përdor, në mënyrë efektive, programet e TIK-ut gjatë procesit të të nxëniet (duke përfshirë edhe të nxëniet në distancë) dhe gjatë kryerjes së detyrave në një fushë të caktuar mësimore.
--	--

Kompetenca e të menduarit
Nxënësi mendon në mënyrë krijuese.

<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - prezanton, në forma të ndryshme të të shprehurit, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informatave për fusha të ndryshme mësimore apo për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse (p.sh.: temë nga shkenca, nga kultura, nga arti, nga sporti, nga shëndetësia, nga shoqëria, nga mjedisi etj.); - krahason, të paktën, tri burime të ndryshme të informacionit për trajtimin e temës së 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - sqaron ecurinë e zgjidhjes së një problemi, në klasë apo jashtë saj, duke e vërtetuar zgjidhjen e problemit përmes metodës së analizës, dhe e prezanton para moshatarëve apo para të tjerëve; - analizon, në mënyrë të pavarur, informacionet e marra nga burimet e ndryshme për një temë ose detyrë të dhënë, vlerëson cilësinë e tyre dhe i radhit ato sipas rëndësisë dhe sipas qëllimit që kanë;
---	--

<p>njëjtë, argumenton saktësinë e rrethanat, gjen ngjashmëritë dhe dallimet, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara më parë, i prezanton gjetjet kryesore para të tjerëve në forma të ndryshme shprehëse, duke përdorur TIK-un;</p> <ul style="list-style-type: none"> - modelon zgjidhjen e një problemi të dhënë (në klasë, apo jashtë saj) për një temë të caktuar nga një fushë mësimore, duke e zbërthyer në hapa të vegjël, dhe jep sqarime të nevojshme për hapat e ndjekur në zgjidhjen e problemit, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit; - krijon një vepër artistike me pamje dy dhe tredimensionale me mesazhe nga një fushë mësimore dhe shpjegon para moshatarëve hapat e ndjekur për krijimin e veprës. 	<ul style="list-style-type: none"> - hulumton, në mënyrë të pavarur, për një çështje të caktuar, duke përcaktuar fazat dhe procedurat e hulumtimit, paraqet dhe interpreton rezultatet e fituara në tabela dhe grafikë, duke përdorur teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit; - identifikon burimet e informacioneve të nevojshme dhe i shfrytëzon ato në mënyrën e duhur për të zgjidhur një problem, duke dhënë shembuj konkretë.
---	--

Kompetenca e të nxënit
Nxënësi mëson për të nxënë.

<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - demonstroi shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në matematikë, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënit të dijeve të reja në ndonjë fushë të caktuar mësimore; - shfrytëzon, në mënyrë efektive, përvojat paraprake gjatë zgjidhjes së situatave të ndryshme në jetën e përditshme apo gjatë kryerjes së ndonjë detyre ose aktiviteti në ndonjë fushë të caktuar mësimore; - përgatit me sukses një përmbledhje të dosjes personale (portofolit), me jo më pak se 900 fjalë, për vetëvlerësimin e përparimit të vet në një fushë mësimore të caktuar, veçon, në fund të përmbledhjes, disa çështje që vërtetojnë përparimin e vet dhe disa nevoja të domosdoshme për përmirësimin e avancimit të mëtejshëm; - shfrytëzon, në mënyrë të pavarur dhe efektive, teknologjinë e informacionit dhe burime të tjera informacioni për të 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - demonstroi shkathtësi të përdorimit të TIK-ut në situata të përditshme dhe në përmbushjen e kërkesave të ndryshme gjatë të nxënit (p.sh., për ndërtimin e tabelave, grafikëve apo diagrameve, për vizatimin e një plani të shtëpisë, apo për përgatitjen e shkresave dhe prezantimeve etj.); - diskuton në grup për mënyrat e bashkëpunimit me të tjerët për të zgjidhur një situatë të re mësimore (ose një problem nga jeta e përditshme, ose për të menaxhuar konfliktet me bashkëmoshatarë), tregon mënyrën e shfrytëzimit të përvojave paraprake për të zhvilluar njohuritë dhe shkathtësitë e reja në zgjidhjen e situatave dhe problemeve të tilla; - shfrytëzon në mënyrën e duhur këshillat dhe informacionet e marra për përkrahje në zgjidhjen e një detyre apo problemi të caktuar, pastaj rezultatet i paraqet para të tjerëve;
--	---

<p>mbledhur materiale për zgjidhjen e një problemi apo detyre të caktuar, të cilat më pas i analizon, i klasifikon dhe i paraqet para të tjerëve përmes TIK-ut dhe ndonjë forme tjetër të shprehjes;</p> <ul style="list-style-type: none"> - kërkon dhe shfrytëzon në mënyrën e duhur këshilla dhe informacione për kapërcimin e vështirësive në të nxënë në një fushë të caktuar dhe, më pas, prezanton rezultatet e arritura; - paraqet idetë personale para të tjerëve për mënyrën e zhvillimit të një aktiviteti të caktuar, duke dhënë mendime të argumentuara për rezultatet e pritshme (në formë skice, grafiku, vizatimi, shkrimi, vepre artistike etj.); - shfrytëzon, në mënyrë të pavarur, udhëzimet e dhëna në ndonjë burim informacioni për të kryer një veprim, aktivitet, detyrë ose për të zgjidhur një problem që kërkohet prej tij, vlerëson vetë performancën dhe rezultatin e arritur, duke iu referuar qëllimeve fillestare (p.sh.: burime informacioni në libër, revistë, enciklopedi, internet, hartë, grafik, skicë, partiturë muzikore, skenar etj.). 	<ul style="list-style-type: none"> - përpunon, në mënyrë të pavarur dhe efektive, informacionet për një temë të caktuar dhe rezultatet e punës i prezanton me shkrim ose me gojë para të tjerëve, duke dhënë shpjegime për mënyrën e zgjedhjes dhe të shfrytëzimit të burimeve të informacionit. - paraqet një plan studimi (në formë skice, vizatimi, shkrimi etj.) për ndonjë çështje të caktuar (p.sh., vlerat kulturore të rajonit të vet, vlerat e edukimit në shoqëri etj.) duke respektuar të gjithë hapat e planit të studimit dhe e paraqet para të tjerëve; - përzgjedh punimet kryesore të dosjes së vet për të shpjeguar para një audience të caktuar strategjitë që ka zbatuar për të ndjekur avancimin e vet dhe masat e që ka marrë për të përmirësuar përparimin në mënyrë të vazhdueshme; - vlerëson, në mënyrë kritike, punën e vet duke iu referuar qëllimeve fillestare të punës, p.sh., në mënyrë të pavarur redakton një dorëshkrim të tij për përmirësimin e organizimit të shkrimit, qartësisë së mendimit etj.; - menaxhon, në mënyrë produktive, burimet që i ka në dispozicion (kohën, njerëzit, mjetet e konkretizimit/punës etj.) gjatë kryerjes së një aktiviteti ose detyre të caktuar në një fushë mësimore apo në situata të jetës së përditshme.
--	---

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive.

<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - harton një projekt me faza të mirëmenaxhuara (individualisht ose në grup) duke shkëmbyer, konsultuar dhe informuar të tjerët si dhe duke identifikuar dhe vlerësuar burimet njerëzore, materiale dhe monetare në përputhje me rezultatet e pritshme; - analizon gjendjen e mjedisit (në klasë, në 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - paraqet, nëpërmjet njërës prej formave të shprehjes, kompetencat e nevojshme për të përballuar situata të ndryshme jetësore apo për zhvillimin e karrierës në një fushë të caktuar; - merr iniciativa të suksesshme për organizimin e aktiviteteve të ndryshme që nxisin bashkëpunimin e ndërmarrjeve me
---	--

<p>shkollë, në komunitet apo më gjerë) dhe pasojat e ndotjes, propozon alternativa për mbikëqyrje dhe menaxhim të drejtë të gjendjes së vlerësuar më të ndjeshme dhe inicicion zgjidhje konkrete;</p> <ul style="list-style-type: none"> - merr pjesë në aktivitete të ndryshme në nivel klase, shkolle, bashkie dhe më gjerë (p.sh., konkurse mësimore, gara sportive, aktivitete kulturore, muzikore etj.), diskuton me të tjerët për rezultatet e arritura dhe për procesin e organizimit dhe jep argumente në forma të ndryshme shprehëse si të rritet pjesëmarrja në aktivitete dhe si të përmirësohet procesi i organizimit të tyre. 	<p>komunitetin, duke promovuar interesin e dyanshëm.</p>
---	--

Kompetenca personale
Nxënësi bën jetë të shëndetshme.

<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - analizon përparësitë dhe dobësitë personale duke evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështesë avancimin personal, në përparësitë që ka dhe masat përmes të cilave synon të përmirësojë dobësitë personale; - merr pjesë aktivisht në lojëra, në gara sportive dhe në aktivitete të tjera kulturore dhe, në mënyrë konstruktive, menaxhon emocionet e veta; - ilustron, me shembuj para të tjerëve, modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - tregon shkathtësi në organizimin e lojërave me të tjerët, të garave sportive, apo aktiviteteve kulturore, dhe menaxhon me sukses emocionet e veta në situata të ndryshme gjatë aktiviteteve dhe gjatë jetës së përditshme; - prezanton, në forma të ndryshme shprehëse, mënyrën e zbatimit të planeve personale të jetës (p.sh., në shkollim, në karrierë, në sport, në shoqëri, në biznes etj.), vlerëson nivelin e arritjes së qëllimeve të synuara dhe ilustron shembuj të veçantë të planeve personale për të ardhmen; - shpreh, në forma të ndryshme, qëndrimin e vet të pavarur për përgjegjësinë e të qenit prind/kujdestar e planifikimin e familjes dhe merr vendime të drejta për të ardhmen e tij.
---	--

Kompetenca qytetare
Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.

Nxënësi:	Nxënësi:
-----------------	-----------------

<ul style="list-style-type: none"> - demonstroi shembuj të pjesëmarrjes demokratike dhe drejton forma të ndryshme të diskutimit për pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes demokratike në nivele të ndryshme (p.sh., në familje, në shkollë, në komunitet, në nivel vendor dhe qendror), gjatë diskutimit tregon tolerancë dhe respekt për pyetjet dhe komentet e të tjerëve; - demonstroi veprime të ndryshme që shprehin tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve në komunitetin ku jeton (në klasë, në shkollë, në lagje dhe me gjerë) dhe i shpjegon ato në një debat me të tjerët; - diskuton me të tjerët apo në një formë tjetër të shprehurit paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj. dhe jep propozime për zgjidhjen e ndonjë problemi në komunitet e më gjerë në një fushë të caktuar. 	<ul style="list-style-type: none"> - prezanton, në forma të ndryshme, se si i ushtron të drejtat e veta në shkollë dhe në jetën e përditshme dhe si i njeh e i respekton të drejtat e të tjerëve, duke dhënë shembuj konkretë; - paraqet, në forma të ndryshme të shprehurit, vlerat kryesore të shumëllojshmërisë në shoqëri apo në mjedisin ku jeton, i diskuton ato me të tjerët, duke i krahasuar me shembuj nga jeta e përditshme që tregojnë tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve; - merr pjesë në proceset demokratike të vendimmarrjes në nivele të ndryshme (në familje, në shkollë, në komunitet etj.), i diskuton me të tjerët përvojat personale dhe paraqet propozime të argumentuara se si të përmirësohet pjesëmarrja demokratike dhe vendimmarrja në shoqëri.
--	--

Kompetenca digjitale

Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.

<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive; - përdor mjetet digjitale për të përpunuar, krijuar, realizuar dhe demonstruar tema mësimore nëpërmjet pamjeve të filmuara apo të animuara; - gjen, organizon, analizon, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediash; - zhvillon aftësitë krijuese, duke zbatuar njohuritë e marra në shkencën kompjuterike dhe mediat digjitale. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor, në mënyrë efektive, programet e TIK-ut për të komunikuar dhe për të bashkëpunuar me bashkëmoshatarët gjatë procesit të të nxënies, duke përfshirë edhe të nxënies në distancë; - vlerëson cilësinë e informacionit të gjetur nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediash; - është aktiv dhe i pavarur në procesin e mësimdhënies dhe të të nxënies për gjetjen dhe përdorimin e metodologjive që lehtësojnë këtë proces.
--	--

5. Lidhja e gjuhës shqipe me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare janë tema që integrojnë fushat e të nxënit dhe që i ndihmojnë nxënësit të kuptojnë e të interpretojnë botën dhe të lidhin dijet e marra në shkollë me jetën dhe me interesat e tyre. Në kornizën kurrikulare janë përcaktuar temat ndërkurrikulare të mëposhtme:

- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.
- Të drejtat e njeriut.
- Vendimmarrja morale.
- Bashkëjetesa paqësore.

Mësimi i gjuhës shqipe, për specifikat dhe hapësirat që ka, lejon krijimin e situatave mësimore që mundësojnë trajtimin e këtyre temave. Kështu p.sh., leximi dhe studimi i teksteve të ndryshme zhvillojnë te nxënësit identitetin kombëtar, si dhe njohjen e vlerësimin e kulturës botërore. Tema, si të drejtat e njeriut, vendimmarrja morale, mjedisi, zhvillimi i qëndrueshëm etj., mund të realizohen gjatë diskutimeve dhe bashkëbisedimeve në grup që mund të zhvillohen gjatë orëve mësimore. Mësuesi mund të krijojë edhe situata mësimore gjatë të cilave nxënësit shprehin në forma të ndryshme: ese dhe shkrime e krijime të tjera me tematikë rreth çështjeve të mësipërme. Punët në grupe që zhvillohen në lëndën e gjuhës e shqipe, ndihmojnë aftësimin e nxënësve për të jetuar në mënyrë paqësore me të tjerët.

5. Lidhja e gjuhës shqipe me fushat e tjera të të nxënit

Gjuha shqipe është jo vetëm disiplinë, por edhe gjuhë e procesit të mësimdhënies dhe e të nxënit. Si e tillë, lidhjet e saj me fushat dhe lëndët e tjera mësimore janë të qarta dhe plotësuese. Një nxënës që nuk zotëron mirë kompetencat gjuhësore, ka pak gjasa të ketë arritje në fushat/lëndët e tjera mësimore. Natyrisht, në këtë lidhje ka marrje dhe dhënie.

Në mënyrë të veçantë lënda e gjuhës shqipe lidhet me lëndët e fushës “Gjuhët dhe komunikimi”. Kështu, letërsia i ofron gjuhës një model të përsosur të përdorimit të gjuhës, ndërsa studimi i gjuhëve të huaja siguron transferimin e njohurive gjuhësore nga një lëndë në një tjetër, por edhe vlerësimin e mundësive shprehëse të gjuhës shqipe.

Lënda e gjuhës shqipe (aftësitë e të lexuarit) mbështet kuptimin e ushtrimeve dhe të teksteve

matematikore. Kjo lëndë është e nevojshme për formimin e koncepteve dhe proceseve matematikore. Aftësitë e mira gjuhësore e lejojnë nxënësin të përmirësojë elementet pamore përfshirë edhe organizimin e grafikëve. Të mësuarit e gjuhës dhe të mësuarit e matematikës janë të ngjashëm në disa pikëpamje: të dyja lëndët përfshijnë situata që u kërkojnë nxënësve të komunikojnë lloje të ndryshme mesazhesh; të dyja lëndët kanë të bëjnë me interpretimin e informacionit, planifikimin, organizimin e ideve dhe përcaktimin e një procedure; të dyja lëndët e ndihmojnë nxënësin të zhvillojë aftësinë për të paraqitur një argument ose një analizë nga këndvështrime të ndryshme; të dyja lëndët përdorin një qasje deduktive.

Kuptimi ose analiza e teksteve të shkencave të natyrës kërkon aftësi të mira leximi. Po kështu, p.sh., leximi i një teksti i ndihmon nxënësit të marrin njohuri rreth natyrës, siç njohuritë e marra në shkencat e natyrës nxitin imagjinatën për të realizuar me shkrim një përshkrim të natyrës.


Në mënyrë të veçantë, lënda e gjuhës shqipe është e lidhur me historinë dhe shkencat shoqërore, përderisa të gjitha tekstet që studiohen nga nxënësit kanë një kontekst historik dhe socio-kulturor.

Mësimi i arteve të ndryshme mbështetet nga lënda e gjuhës shqipe. Kështu, analiza e teksteve të ndryshme me tematikë nga arti, ndihmon nxënësit për lëndët e arteve. Gjithashtu, studimi dhe krijimi i teksteve të ndryshme si p.sh., i reklamave, kërkon integrim me artet për elementet pamore të reklamave etj.

Shembujt e mësipërm janë vetëm një nxitje për të kuptuar se në procesin mësimor krijohen mundësi për integrim mes fushave të të nxënësve. Mësuesit, me pasionin dhe përkushtimin që i karakterizon, mund të realizojnë pafund integrimet mes fushave dhe lëndëve në situata të ndryshme të nxënësve. Ky integrim i lejon nxënësit të mos marrin njohuri të fragmentuara dhe të shkëputura nga jeta.

Gjuha shqipe jo vetëm kontribuon, por edhe përdor njohuritë, aftësitë dhe shkathhtësitë e fituara në lëndët e tjera. Kështu, në një projekt nxënësit përdorin TIK-un, nxjerrin fakte historike, përpunojnë të dhëna etj. Pra, për të përfunduar me sukses këtë detyrë, nxënësit integrojnë njohuritë e fituara nga fusha të ndryshme të dijes (TIK dhe Histori).

Në diagramin e mëposhtëm janë pasqyruar disa nga lidhjet mes gjuhës shqipe dhe lëndëve të tjera.



6. Kompetencat e lëndës dhe përshkrimi i tyre

Puna për ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave të lëndës nuk është e copëzuar dhe fragmentare. Çdo orë mësimore kontribuon për to. Kompetencat ndërlihen dhe plotësojnë njëra-tjetrën. Kështu, kompetenca e të lexuarit e teksteve të ndryshme (njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet e kësaj kompetence) ndikon në aftësimin e nxënësve për të shkruar dhe për të

folur, ndërsa formimi i nxënësve rreth sistemit gjuhësor të shqipes ndikon në zhvillimin e kompetencave të tjera.

Më poshtë janë dhënë përshkrimet e kompetencave të lëndës.

a) Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar

Të folurit është mjete themelor i komunikimit me të tjerët dhe gur themeli i të mësuarit në të gjitha lëndët mësimore. Duke folur dhe duke biseduar nxënësit jo vetëm japin informacion, por edhe sqarojnë kuptimin dhe domethënien e koncepteve të ndryshme, identifikojnë dhe zgjidhin probleme, zgjerojnë njohuritë, si dhe shprehin mendimet, ndjenjat dhe opinionet e tyre.

Kur ata diskutojnë rreth një informacioni, njohin dhe pranojnë edhe këndvështrimet e bashkëbiseduesve të tjerë, si dhe mjetet gjuhësore apo stilin që ata përdorin.

Në arsimin e mesëm të lartë, nxënësit përmirësojnë aftësitë e tyre për të komunikuar dhe për të prezantuar ide në klasë dhe në situata formale. Nëpërmjet këtyre situatave, nxënësit aftësohen edhe për të folurit në publik.

Ata mësojnë të flasin qartë, bindshëm e me vetëbesim dhe të jenë tërheqës për të tjerët:

- duke përdorur gjuhën standarde, sidomos kur këtë e dikton situata dhe dëgjuesit;
- duke diskutuar në grupe të vogla dhe të mëdha, duke marrë role të ndryshme në menaxhimin dhe në moderimin e diskutimeve dhe debateve, si dhe duke përfshirë e angazhuar të tjerët për të përmbushur afatet dhe qëllimet;
- duke respektuar, gjatë prezantimeve me gojë, karakteristikat e një fjalimi, shpjegimi, raportimi, debati etj.;
- duke përzgjedhur fjalët e fjalitë e përshtatshme dhe duke përdorur mjete retorike e të figurshme;
- duke përdorur dhe duke vlerësuar TIK-un gjatë prezantimeve në aktivitete të ndryshme në shkollë dhe jashtë saj.

b) Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme

Gjatë arsimit të mesëm të lartë, nxënësit reflektojnë ndaj informacioneve të llojeve dhe të fushave të ndryshme; përmbledhin, parafrazojnë dhe vlerësojnë përmbajtjen e informacionit të dëgjuar; analizojnë stilin dhe strukturën e një fjalisë ose të një teksti të dëgjuar; përqendrohen te

folësi, diskutojnë dhe zgjerojnë idetë e dëgjuara; mbajnë shënime të tilla që demonstrojnë të dëgjuarit e qëllimshëm etj.

c) Të lexuarit e teksteve të ndryshme

Edhe pse disa nxënës që hyjnë në klasën e dhjetë, janë lexues të pavarur, shumë prej tyre mund të kenë nevojë për mbështetje, me qëllim që të zhvillojnë më tej aftësitë në lexim. Pra, ky proces duhet të vijojë edhe në arsimin e mesëm të lartë.

Përveç kësaj, të gjithë nxënësit përballen me sfidat që shtron programi i gjuhës shqipe, i cili kërkon nga nxënësit të përvetësojnë koncepte gjithnjë e më abstrakte, të përdorin struktura gjuhësore më komplekse, si dhe të kenë fjalor më të pasur se në arsimin bazë.

Lënda e gjuhës shqipe i ndihmon nxënësit që të lexojnë në mënyrë aktive dhe kritike, si dhe ta përthithin mirë e shpejt informacionin. Një lexues aktiv dhe kritik është ai që jo vetëm i kupton njohuritë që komunikohen në një tekst, por edhe i përdor ato në kontekste të reja. Për ta realizuar këtë, nxënësit zbatojnë një sërë strategjish të të kuptuarit, si dhe njihen me një shumëllojshmëri tekstesh.

Njohja me tekste të ndryshme u jep mundësinë nxënësve që të zbulojnë interesat dhe prirjet e tyre dhe, gjithashtu, ta kenë më të lehtë të zgjedhin orientimin e karrierës së tyre.

d) Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale

Të shkruarit u jep mundësi nxënësve të mësojnë për veten e tyre dhe të lidhen me botën.

Një nga qëllimet e programit të gjuhës shqipe është që nxënësit të demonstrojnë siguri dhe saktësi kur shkruajnë, të hulumtojnë para se të shkruajnë një tekst, si dhe të komunikojnë me kompetencë, duke përdorur forma dhe stile të ndryshme të shkruarit.

Gjatë tri viteve, nxënësit krijojnë, organizojnë dhe përzgjedhin ide për të shkruar për qëllime, audienca dhe situata të ndryshme. Ata zbatojnë hapat e domosdoshëm të procesit të shkrimit (planifikimi, organizimi i punës me shkrim, rishikimi, redaktimi etj.). Nxënësit zbatojnë, gjatë të shkruarit, karakteristikat e teksteve dhe rregullat gramatikore e drejtshkrimore.

e) Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit

Në arsimin e mesëm të lartë, nxënësit demonstrojnë ndërgjegjësime dhe saktësi në përdorimin e njohurive rreth sistemit gjuhësor të shqipes. Ata i konsolidojnë njohuritë gjuhësore, aftësohen ta

përdorin gjuhën saktë dhe brenda rregullave gramatikore. Nxënësit i përdorin njohuritë gjuhësore për të organizuar, për të redaktuar dhe për të përmirësuar shkrimet e tyre, për të folur qartë dhe saktë, për të gjykuar gjuhën e një teksti që dëgjojnë ose lexojnë etj. Në këtë cikël, nxënësit përcaktojnë dallimet mes gjuhës së folur e gjuhës së shkruar, analizojnë regjistrat e gjuhës, vlerësojnë pasurinë leksikore të gjuhës shqipe dhe zbatojnë rregullat drejtshkrimore dhe të pikësimit.

7. Ndarja e kohës mësimore për secilën klasë

Gjuha shqipe zhvillohet përgjatë tri viteve të arsimit të mesëm të lartë. Në tabelën e mëposhtme është dhënë koha mësimore për shkallën e pestë dhe shkallën e gjashtë (klasat X-XII).

Klasa/ shkalla	X	XI	Shkalla V	XII	Shkalla VI
Orë/javë	2				
Javë mësimore	34				
Orë gjithsej	68				

Koha mësimore përdoret:

- për njohuri të reja;
- për përsëritje;
- për testime;
- për ushtrime;
- për punë me shkrim ose ese;
- për vetëvlerësime;
- për projekte kurrikulare etj.

Gjatë çdo ore mësimi në lëndën e gjuhës shqipe, nxënësit flasin, dëgjojnë, lexojnë, shkruajnë dhe fitojnë njohuri dhe shkathtësi rreth sistemit gjuhësor. Kjo do të thotë që çdo orë mësimi shërben për ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave lëndore. Orët e mësimi shërbejnë edhe për zhvillimin e kompetencave kyçe.

Sugjerime të ndarjes së kohës mësimore sipas klasave

Klasa X

Ndarjet kryesore	Orë mësimi të sugjeruara
<p>Të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit dhe të shkruarit e teksteve të ndryshme (përshkruese, rrëfyese, argumentuese, udhëzuese, informuese-paraqitëse).</p> <p><i>Shënim. Koha mësimore duhet të shpërndahet në mënyrë të barabartë (afërsisht) mes llojeve të teksteve.</i></p>	40
<p>Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit</p> <p><i>Shënim. Njohuritë gramatikore, rregullat e drejtshkrimit dhe të pikësimit duhet të integrohen me studimin e teksteve përshkruese, rrëfyese, argumentuese, udhëzuese, paraqitëse.</i></p>	28
Gjithsej:	68

II. PËRMBAJTJA E SHKALLËS SË PESTË



KLASA X

Shënim. Tekstet që do të përzgjidhen për t'u punuar me nxënësit, duhet të trajtojnë edhe tema, të tilla si:

- Prejardhja e gjuhës shqipe.
- Dokumentet dhe shkrimet e para në gjuhën shqipe (Buzuku, Bardhi, Budi, Bogdani).
- Kongresi i Manastirit dhe rëndësia e tij në historinë e shkrimit të gjuhës shqipe.
- Drejtshkrimi i gjuhës shqipe. Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe. Parimet ku mbështetet drejtshkrimi i gjuhës shqipe.

Kompetenca: Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar

Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë

Nxënësi:

- merr pjesë në diskutime për tema të ndryshme, mbështet ose kundërshton një pozicion të caktuar, merr në konsideratë qëllimin, audiencën dhe situatën në një diskutim, si dhe përmbledh përfundimet e një diskutimi;

- dallon karakteristikat e gjuhës së folur si një formë komunikimi, si dhe krahason përdorimet e kësaj gjuhe në shkollë dhe në komunitet;
- realizon prezantime të ndryshme me gojë, përdor strategjitë e duhura për të përmbushur qëllimin që ka dhe, për të tërhequr vëmendjen dhe interesin e audiencës, respekton kohën gjatë prezantimit;
- përdor TIK-un për të realizuar prezantime të ndryshme, sidomos në situata formale.

Njohuritë	Shkathtësitë
<ul style="list-style-type: none"> - Procesi i komunikimit gjatë të folurit. Gjuha verbale dhe joverbale. Karakteristikat e gjuhës së folur. Të shkruarit dhe të folurit, dallimi mes tyre. - Strategjitë e të folurit. Rëndësia e përdorimit të gjuhës standarde gjatë të folurit. Mjetet që përdoren për të tërhequr vëmendjen dhe interesin e të tjerëve. - Karakteristikat e një diskutimi. Rolet në një diskutim. - Hartimi i një prezantimi, mënyrat dhe mjetet e prezantimit (përfshirë edhe TIK-un). 	<p>Komunikimi dhe gjuha gjatë të folurit</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përcakton elementet e komunikimit gjatë të folurit; - veçon karakteristikat e gjuhës së folur; - përcakton dallimet mes gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar; - dallon dhe vlerëson rolin e fjalës dhe të gjuhës joverbale gjatë të folurit (gjestet, mimika, toni i zërit, gjuha e trupit etj.); - përdor intonacionin e duhur, theksin e saktë (të fjalëve dhe të fjalive), volumin e përshtatshëm të zërit, si dhe pauzat për të bërë përshtypje te të tjerët; - përzgjedh fjalët, shprehjet, terminologjinë e duhur dhe mjetet stilistike për të shprehur mendimet, idetë, ndjenjat dhe opinionet e tij, si dhe për të ndikuar tek audiencia. <p>Diskutimi dhe bashkëveprimi në grup</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - komunikon për qëllime, tematika dhe audiencia të ndryshme;

- mban një qëndrim të caktuar gjatë një diskutimi në grup;
- dallon rolet e ndryshme në një diskutim, si: rolin e moderatorit, rolin e drejtuesit, rolin e dëgjuesit etj.;
- paraqet mendimin personal mbi çështjen për të cilën diskutohet;
- shpreh mendimet e tij në mënyrë të përmbledhur, duke respektuar kohën;
- përmbledh përfundimet e një diskutimi;
- shpreh një mesazh koherent;
- merr parasysh rolin e qëllimit, të audiencës dhe të situatës në një diskutim;
- shfrytëzon pasurinë leksikore e semantike për të shprehur saktë mendimet e tij gjatë diskutimeve në grupe të vogla e të mëdha;
- bën pyetjet e duhura, kur diskutohen tema të ndryshme;
- u përgjigjet pyetjeve të të tjerëve duke dhënë sqarime dhe ilustrime;
- identifikon faktorët (organizimi, stili, mjetet letrare, përzgjedhja e fjalëve, toni, përmbajtja, këndvështrimi etj.) që ndikojnë në kompozimin e mesazhit të tij.

Prezantimi me gojë

Nxënësi:

- përgatit në mënyrë individuale një prezantim rreth një teme familjare ose interesante për moshën e tij;
- prezanton në grup për një çështje/temë të

	<p>caktuar;</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor një shumëllojshmëri strategjish organizative (tabela, diagrame, grafikë, kllaster); - demonstroi strategji efektive të përcjelljes së mesazhit gojor (organizimi, gjuha e gjesteve, fjalor i përshtatshëm); - përpunon prezantimin gojor për të orientuar drejt audiencën; - përdor TIK-un gjatë prezantimeve; - përdor një shumëllojshmëri elementesh joverbale, si shprehja e fytyrës, gjestet, kontakti me sy etj., në mënyrë që të përcjellë si duhet idetë e tij, por edhe që të ndikojë tek audienca; - respekton kohën në prezantimet me gojë.
--	---

Vlerat dhe qëndrimet

Nxënësi:

- përfshihet në diskutime duke dhënë kontributin e tij, si dhe respekton mendimin e të tjerëve;
- kontrollon nervozizmin dhe demonstroi seriozitet dhe sinqeritet gjatë të folurit;
- respekton forcën e fjalës dhe pasurinë leksikore të gjuhës shqipe;
- ndërmerri iniciativa dhe shpreh interesim për çështje të ndryshme;
- përdor imagjinatë dhe kreativitet për zgjidhjen e problemeve;
- përdor teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit gjatë prezantimeve të ndryshme;
- respekton parimet, vlerat, bindjet dhe kulturën e të tjerëve;
- tregon vetëbesim, imagjinatë dhe shpirt krijues gjatë të folurit.

Kompetenca: Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme

Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë

Nxënësi:

- përdor strategjitë e të dëgjuarit dhe kupton tekste të llojeve të ndryshme
- bën identifikimin e tipareve të formës e të përmbajtjes së teksteve;
- zbulon kuptimin e fjalës duke hetuar mbi origjinën e saj, analizon dhe interpreton kuptimet e dyta dhe të figurshme që merr fjala brenda një konteksti;
- përdor materiale udhëzuese dhe hulumton në leksikun e teksteve të ndryshme për të pasuruar fjalorin;
- analizon gjuhën e figurshme të tekstit;
- identifikon faktin dhe opinionin në tekste të ndryshme;
- identifikon mjetet që përdor folësi për ta bërë tërheqës ose të besueshëm të folurën e tij.

Njohuritë

- Studime tekstesh të ndryshme.

Shkathtësitë

Të dëgjuarit për të kuptuar dhe për të reflektuar

Nxënësi:

- demonstroi të kuptuarit e tekstit që dëgjon;
- përmbledh informacionin e prezantuar me gojë nga të tjerët;
- vlerëson përmbajtjen dhe mënyrën e prezantimit gojor;
- përgjigjet në mënyrë të përshtatshme në një debat.

Të dëgjuarit për të vlerësuar

Nxënësi:

- përqendron vëmendjen në mënyrë të përgjegjshme mbi folësin ose mesazhin;
- mban shënime të atilla që demonstrojnë të dëgjuarit e qëllimshëm;
- zbulon kuptimin e fjalëve të reja nëpërmjet

	kontekstit në komunikimet gojore; - tregon si zgjedhja e fjalëve dhe e gjesteve zbulojnë qëllimin e folësit; - vlerëson besueshmërinë e folësit; - dallon faktet dhe opinionet në një tekst.
Vlerat dhe qëndrimet	
Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> - tregon respekt, empati (ndjeshmëri) dhe interes ndaj folësit; - demonstroi vullnet gjatë kryerjes së detyrave; - ndërmerri iniciativa dhe shpreh interes për çështje të ndryshme; - përdori imagjinatë dhe kreativitet për zgjidhjen e problemeve; - respekton parimet, vlerat, bindjet dhe kulturën e të tjerëve. 	

Kompetenca: Të lexuarit e teksteve të ndryshme
Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> - përdori strategjitë e të lexuarit dhe bëri identifikimin e tipareve të formës e të përmbajtjes së teksteve; - përdori organizuesit grafikë në funksion të procesit të të kuptuarit të tekstit, parafrazon dhe përmbledh tekstet e punuara; - kupton tekste të llojeve të ndryshme; - zbulon kuptimin e fjalës duke hetuar mbi origjinën e saj, analizon dhe interpreton kuptimet e dyta dhe të figurshme që merr fjala brenda një konteksti; - përdori materiale udhëzuese dhe gjurmon në leksikun e teksteve të ndryshme për të pasuruar fjalorin; - analizon tema të ndryshme, duke zbuluar gjuhën e figurshme të tekstit; - identifikon faktin dhe opinionin në tekste të ndryshme; - realizon punë kërkimore, përzgjedh informacione për qëllime të ndryshme, vlerëson informacionin e përzgjedhur nga të tjerët, përmbledh materiale të ndryshme, si dhe nxjerr

përfundime.	
Njohuritë	Shkathtësitë
<ul style="list-style-type: none"> - Teksti, karakteristikat e tij. Struktura e një teksti. <p>Llojet e teksteve.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Tekstet e gjuhës së folur, të shkruar dhe mediatike. - Tekstet mediatike (publiciteti, reklama etj.). - Teksti letrar dhe teksti joletrar. <p>Tekstet përshkruese.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Teknikat e përshkrimit. - Gjuha dhe stili i një teksti përshkrues. - Përshkrimi i një personi, i një objekti, i një vendi. <p>Tekstet rrëfyese.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Teknikat e shkrimit të teksteve rrëfyese. - Tekstet rrëfyese letrare dhe joletrare. - Karakteristikat strukturore, gjuhësore dhe stilistike të shkrimit rrëfyës. <p>Tekstet udhëzuese.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Teknikat dhe karakteristikat strukturore, gjuhësore dhe stilistike të teksteve udhëzuese. <p>Tekstet argumentuese.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Teknikat e shkrimit të teksteve argumentuese. - Karakteristikat strukturore, gjuhësore dhe stilistike të teksteve argumentuese. <p>Tekstet informuese-paraqitëse.</p>	<p>Të kuptuarit e tekstit dhe reflektimi ndaj tij</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - lexon tekste nga kultura dhe periudha historike të ndryshme; - përdor një sërë strategjish të ndryshme para, gjatë dhe pas leximit ose dëgjimit, me qëllim që të përftojë kuptimin e teksteve të thjeshta dhe më komplekse, si p.sh.: <ul style="list-style-type: none"> ∫ parashikon rreth përmbajtjes së teksteve; ∫ aktivizon njohuritë e mëparshme për përmbajtjen ose veçoritë organizative dhe grafike të teksteve; ∫ përcakton qëllimin e leximit të teksteve; ∫ shtron pyetje për veten për t'u qartësuar ose për të përmbledhur konceptet dhe idetë; ∫ rilexon një fragment të vështirë të tekstit; ∫ nënvizon dhe mban shënime; ∫ krijon një organizues grafik për një tekst ose kapitull për të memorizuar (kujtuar) informacionin; ∫ harton një hartë koncepti; ∫ lidh informacionin e tekstit me jetën dhe përvojat e tij;

<ul style="list-style-type: none"> - Karakteristikat strukturore, gjuhësore dhe stilistike e teksteve informuese-paraqitëse. - Teknikat e shkrimit të teksteve informuese-paraqitëse. <p>Shënim. Nxënësit do të njohin dhe do të punojnë me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - tekste përshkruese; - tekste rrëfyese; - tekste udhëzuese; - tekste argumentuese; - tekste informuese-paraqitëse. 	<ul style="list-style-type: none"> - lexon informacion shtesë për të plotësuar informacionin e tekstit; - analizon tekstin, veçoritë dhe strukturën e tij; - përdor informacionin e tekstit për të zbuluar nëntekstin dhe për të nxjerrë përfundime; - dallon informacionin kryesor nga informacioni jokryesor; - parafrazon informacionin e marrë nga tekste të ndryshme; - bën përmbledhjen e një teksti; - zbulon elemente të stilit dhe të gjuhës së autorit; - zbulon qëllimin dhe qëndrimin e autorit në një tekst; - dallon dhe gjykon për problematika të natyrave të ndryshme që pasqyrohen në tekste të ndryshme; - analizon se si teksti i një periudhe kohore ose i një kulture të caktuar reflekton kushtet historiko-shoqërore dhe kulturore të kohës; - analizon gjuhën e figurshme të një teksti; - dallon faktin nga opinioni në një tekst, duke argumentuar përgjigjen e tyre; - dallon referencat dhe gjykon për besueshmërinë e një teksti; - krahason tekste të llojeve të ndryshme; - krahason një tekst letrar me një tekst joletrar.
---	---

Llojet e teksteve

Nxënësi:

- evidenton karakteristikat e teksteve të gjuhës së folur, të shkruar dhe mediatike;
- përcakton veçoritë e teksteve mediatike;
- gjykon për vlerën dhe ndikimet e teksteve mediatike në jetën e njeriut;
- dallon karakteristikat kryesore të tekstit letrar dhe të tekstit joletrar;
- përcakton funksionet, llojin, qëllimet teknikat dhe karakteristikat gjuhësore, stilistike dhe strukturore të teksteve joletrare, si:
 -) teksti përshkrues,
 -) teksti rrëfyes,
 -) teksti udhëzues,
 -) teksti argumentues,
 -) teksti informues-paraqitës.

Pasurimi i fjalorit

Nxënësi:

- përdor materiale udhëzuese (p.sh.: fjalorë, enciklopedi, internet etj.), që janë të përshtatshme për të pasuruar fjalorin në fusha të ndryshme;
- hulumton fjalët e shkrimeve të ndryshme për të pasuruar fjalorin;
- përdor njohuritë e origjinës së fjalëve, si dhe të dhënat e kontekstit historik për të përcaktuar kuptimin e fjalëve të fushave të caktuara të dijes;
- përdor dukuri të tilla gjuhësore, si:

	polisemia, homonimia, onomatopetë, shprehjet frazeologjike, sinonimia, antonimia për të rritur forcën shprehëse të mendimit të tij.
Vlerat dhe qëndrimet	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - është i motivuar për të lexuar për kënaqësi dhe informacion; - është i vëmendshëm gjatë leximit; - shfaq empati (ndjeshmëri) gjatë leximit; - shfaq vetëbesim dhe vetëvlerësim; - demonstroi vullnet gjatë kryerjes së detyrave; - respekton dhe pranon mendimin e të tjerëve; - respekton etikën gjatë komunikimit personal dhe në grup; - vlerëson kontributin e të tjerëve gjatë kryerjes së një detyre; - shfaq tolerancë dhe respekt për kulturën dhe për gjuhën e tjetrit. 	

Shënim. Nxënësi, përgjatë një viti shkollor, lexon dhe shkruan, pothuajse, të njëjtat lloje tekstesh. Sugjerohet që shkrimi i tekstit të realizohet, pasi është lexuar dhe studiuar ai lloj teksti nga nxënësi.

Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale
<p>Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - realizon hapat e përcaktuar dhe të domosdoshëm gjatë të shkruarit, përdor strategji të ndryshme për të planifikuar shkrimin e tij, organizon në mënyrë logjike mendimet dhe idetë, redakton shkrimin duke përdorur edhe mendimet e të tjerëve; - shkruan qartë, me një stil vetjak dhe në mënyrë logjike, tekste për qëllime dhe për audienca të ndryshme; - shkruan tekste të llojeve të ndryshme për qëllime personale dhe funksionale, duke zbatuar

<p>kriteret e domosdoshme për secilin lloj (formë);</p> <ul style="list-style-type: none"> - zbaton rregullat gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit në shkrimet e tij dhe në procesin e redaktimit; - përdor materiale të ndryshme burimore që e ndihmojnë gjatë procesit të shkrimit. 	
Njohuritë	Shkathtësitë
<ul style="list-style-type: none"> - Procesi i të shkruarit, hapat dhe strategjitë e të shkruarit. - Përshkrimi i një personi (tekst përshkrues). - Shkrimi i një përvoje personale ose shkrimi i një kronike për një ngjarje (tekst rrëfyes). - Udhëzime se si arrihet në një destinacion (vendmbërritje). - Ese argumentuese (tekst argumentues). - Shkrimi i një teksti informues/ paraqitës. 	<p>Shkrimi si proces</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përcakton qëllimin, temën dhe audiencën për të cilën shkruan si p.sh., një rrëfim para shokëve dhe shoqeve të klasës për një moment të rëndësishëm në jetën e tij, një artikull për një çështje lokale në një gazetë që botohet në qytetin/bashkinë e tij etj.; - ndjek të gjitha hapat e procesit të të shkruarit; - kërkon dhe përzgjedh informacion në burime të ndryshme (të shtypura ose elektronike) për të mbështetur idetë e tij në punën me shkrim; - harton një strukturë ose një skedë për tekstin që do të shkruajë; - redakton shkrimin duke u përqendruar në elementet e përmbajtjes dhe të formës si: <ul style="list-style-type: none"> ∫ dhënia e informacionit të nevojshëm; ∫ përmirësimi i stilit dhe i origjinalitetit; ∫ respektimi i strukturës dhe i koherencës së tekstit; ∫ përdorimi i gjuhës standarde,

respektimi i i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe i shenjave të pikësimit;

J) respektimi i leksikut dhe i terminologjisë në varësi të llojit dhe tematikës së tekstit;

J) plotësimi i tekstit me elemente grafike, kur këto janë të nevojshme;

- përdor (shfrytëzon) mendimet dhe sugjerimet e të tjerëve për të redaktuar përmbajtjen dhe organizimin e pjesës së shkruar;
- përdor njohuri rreth rregullave të pikësimit për të redaktuar shkrimin e tij dhe të të tjerëve;

Shkrimi si produkt

Nxënësi:

- përdor në shkrimet e veta tonin dhe veçoritë e gjuhës së teksteve të ndryshme;
- zhvillon dhe organizon idetë kryesore duke i mbrojtur ato me nënide, shembuj dhe ilustrime;
- shkruan tekste me disa paragrafë duke zhvilluar një ide kryesore;
- përdor gjuhën e përshtatshme, lloje të ndryshme fjalish pjesë të ndryshme të ligjëratës, detaje specifike, përshkrime dhe shembuj për ta bërë tërheqës shkrimin e tij;
- shkruan hyrje dhe mbyllje tërheqëse dhe

	<p>koherente;</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor rrallë, por në mënyrë efektive klishtë, zhargonet dhe fjalët dialektore; - përdor grafikë, tabela ose diagrame për të mbështetur idetë kryesore; - përdor struktura të tilla si: kronologjia, sekuenca, titujt, nëntitujt etj., të cilat e ndihmojnë lexuesin që të kuptojë shkrimin; - përdor lidhëzat dhe fjalët lidhëse për të lidhur paragrafët; - përdor gjuhën standarde dhe zbaton rregullat drejtshkrimore në të gjitha punët me shkrim; - zbaton rregullat e pikësimit në të gjitha shkrimet e tij; - përdor dhe zhvillon stilin vetjak për të tërhequr vëmendjen e audiencës; - zbaton të drejtën e autorit ndaj informacionit që përdor në punët me shkrim. <p>Llojet e teksteve</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shkruan tekste përshkruese për qëllime dhe audiencë të ndryshme; - shkruan tekste rrëfyese për qëllime dhe audiencë të ndryshme; - shkruan tekste udhëzuese për qëllime dhe audiencë të ndryshme; - shkruan tekste argumentuese për qëllime dhe audiencë të ndryshme;
--	---

	<ul style="list-style-type: none"> - shkruan tekste informuese/paraqitëse për qëllime dhe audiencë të ndryshme.
--	--

Vlerat dhe qëndrimet

Nxënësi:

- shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të shkruarit;
- demonstroi imagjinatë dhe shpirt krijues gjatë shkruarit;
- shkruan në mënyrë të pavarur;
- respekton gjuhën standarde dhe shmang fjalët e huaja gjatë shkruarit (kur e kanë fjalën përgjegjëse në gjuhën shqipe);
- vlerëson punët e tjerëve;
- bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre me shkrim.

Kompetenca: Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit

Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë

Nxënësi:

- ndërton dhe zhvillon njohuri të reja rreth gramatikës dhe leksikologjisë përmes studimit të funksionit dhe ndikimit të tyre në tekstet që lexon;
- përdor njohuritë gramatikore dhe leksikore gjatë folurit dhe shkruarit për të arritur

<p>qëllime ose efekte të caktuara;</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon disa ndryshime mes gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar, mes regjistrave formalë dhe joformalë, mes dialekteve dhe gjuhës standarde; - zotëron rregullat e drejtshkrimit dhe të pikësimit në gjuhën shqipe; - shkruan saktë, pa gabime, dhe argumenton mënyrën e të shkruarit, duke cituar rregullat drejtshkrimore; - përdor me saktësi terminologjinë gjuhësore në diskutime gjatë të folurit dhe kur shkruan. 	
Njohuritë	Shkathtësitë
<p>Morfologji (10 orë të sugjeruara)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Klasat e fjalëve, të ndryshueshme dhe të pandryshueshme. <p>Emri</p> <ul style="list-style-type: none"> - Emrat që e ndërrojnë gjininë në numrin shumës. - Emrat që e formojnë shumësin me prapashtesa, si: <i>-ë, -nj, -ër, -injt, -ra</i> ose me ndërrime tingujsh. - Emrat që kanë të njëjtën temë, si në njëjës, ashtu edhe në shumës. - Emrat që përdoren vetëm në numrin njëjës. Emrat që përdoren vetëm në numrin shumës. - Emrat me dy trajta shumësi. 	<p>Morfologji</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përcakton klasat e fjalëve dhe argumenton përgjigjen e tij; - klasifikon fjalët në të ndryshueshme dhe në të pandryshueshme; - dallon emrat e gjinisë mashkullore që e ndryshojnë gjininë, kur kalojnë në numrin shumës; - përcakton prapashtesën me të cilën e formojnë numrin shumës, disa emra mashkullorë, si: <ul style="list-style-type: none"> ∫ prapashtesën <i>-e</i> (<i>shtigje, male, vende, mendime, personazhe, insekte</i> etj.); ∫ prapashtesën <i>-ra</i> (<i>djathëra, vajra, mallra, ujër, shira</i> etj.); - përdor drejt emrat që në numrin shumës marrin prapashtesat <i>ë, -nj, -ër, -injt, -ra</i> ose ndërrojnë tingujt si p.sh.: <i>dibranë, drejtorë, arsimtarë, florinj priftërinjt, prindër, erëra, brigje, kapituj</i> etj.; - dallon emrat që përdoren vetëm në njëjës

<p>Folja</p> <ul style="list-style-type: none"> - Foljet kalimtare dhe jokalimtare. - Mënyra dëftore dhe habitore, forma veprare dhe joveprare e foljeve të parregullta. - Format e pashtjelluara foljore. Pjesorja e foljes. 	<p>(<i>benzinë, brymë, latinishtja</i> etj.) dhe emrat që përdoren vetëm në numrin shumë (qelqurina, të ardhura, shtojzovalle, Alpe etj.);</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor në trajtën e duhur emrat që kanë të njëjtën temë si në njëjës, ashtu edhe në shumë si p.sh.: <i>nxënës, lagje, radio, qeveri</i> etj.; - dallon dhe përdor drejt emrat që kanë dy trajta shumësi si p.sh.: <i>pikë dhe pika</i>; - dallon dhe krahason foljet kalimtare dhe jokalimtare; - ndërton fjali me folje kalimtare dhe jokalimtare; - zgjedhon foljet e parregullta (<i>jam, them, rri, dua</i> etj.) në kohët e mënyrës dëftore dhe habitore, në formën veprare dhe joveprare; - dallon variantin e saktë të foljet që në gjuhën e folur kanë disa trajta si p.sh.: <i>shkoj/shkoi/ shkonj, shkoja/shkonja, por</i> edhe trajtën kryesore normative <i>mat/mas, matja/masja, flitni/flisni; bërtisni/bërtitni</i> etj. - përcakton format e pashtjelluara që ndërtohen mbi bazën e pjesores; - klasifikon mbiemrat duke u mbështetur në tiparin që emërtojnë (mbiemra cilësorë dhe mbiemra marrëdhënie); - vendos në trajtën e duhur mbiemrat ose fjalët e tjera përcaktuese pas emrave që e ndërrojnë gjininë në numrin shumë si
---	---

<p>Mbiemri</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shumësi i mbiemrave. Përdorimi në shumës i mbiemrave që përcaktojnë emra mashkullorë me shumësin me - e, - ra dhe me -a. 	<p>p.sh.: <i>mendime të zymta, personazhe interesante, vende malore, ujëra të rrëmbyeshme, djathëra të kripura</i> etj.;</p> <ul style="list-style-type: none"> - përcakton saktë shumësin e mbiemrave (relativë, shumëngjyrësh etj.).
<p>Sintaksë (10 orë të sugjeruara)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjymtyrët e fjalisë. - Përshtatja, në vetë dhe në numër, e kallëzuesit foljor dhe e këpujës me kryefjalën. Përshtatja e gjymtyrës emërore me kryefjalën. - Fjalja dëftore. Rendi i gjymtyrëve në fjalinë dëftore. - Fjalja e paplotë. Fjalitë e paplota kontekstuale, situative. - Gjymtyrët homogjene - Përshtatja e mbiemrit ose e përemrit që përcakton një varg gjymtyrësh homogjene. - Përdorimi i nyjave, i parafjalëve, i pjesëzave para gjymtyrëve homogjene. - Përdorimi i foljeve ndihmëse në kallëzuesit foljorë homogjenë. - Gjymtyrët e veçuara. 	<p>Sintaksë</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përcakton gjymtyrët në një fjali dhe argumenton përgjigjen e tij; - dallon se si përshtaten kallëzuesi foljor dhe këpuja me kryefjalën, në vetë dhe në numër; - dallon përshtatjen e gjymtyrës emërore me kryefjalën; - përcakton dhe përdor drejt rendin e gjymtyrëve në fjalinë dëftore; - dallon kur rendi (kryefjalë- kallëzues ose kallëzues-kryefjalë) është i drejtë ose i anasjelltë dhe përcakton në cilat raste përdoren ato; - përcakton vendin e gjymtyrëve të dyta (kundrinor, përcaktor etj.); - tregon se çfarë janë fjalitë e paplota dhe bën krahasimin e këtyre fjalive me fjalitë e plota; - përcakton fjalitë e paplota të kontekstit dhe fjalitë e paplota të situatës; - dallon gjymtyrët homogjene në fjali; - dallon dhe përdor përsëritjen ose jo të

	<p>nyjeve të përparme, të parafjalëve dhe të pjesëzave para gjymtyrëve homogjene;</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor drejt mbiemrat ose përemrat që përcaktojnë një varg gjymtyrësh homogjene; - përdor drejt foljet ndihmëse në kallëzuesit foljorë homogjenë; - dallon dhe përdor në fjali gjymtyrët e veçuara.
<p>Leksikologji (3 orë të sugjeruara)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Leksiku i gjuhës shqipe. - Shtresat e leksikut sipas burimit - Shtresat e leksikut sipas përdorimit. 	<p>Leksikologji</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - gjykon dhe vlerëson leksikun e pasur të shqipes; - identifikon shtresat e leksikut sipas burimit dhe sipas përdorimit; - dallon dhe analizon karakteristikat e secilës shtresë të leksikut të shqipes.
<p>Drejtshkrim dhe pikësim (5 orë të sugjeruara)</p> <p>Shënim: <i>Këto orë duhet të zhvillohen të integruara me njohuritë gramatikore. P.sh., do të shihet përdorimi i presjes te gjymtyrët homogjene (me dhe pa lidhëza), te gjymtyrët e veçuara të fjalisë etj.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Drejtshkrimi i emrave të përveçëm dhe i emërtimeve me to. - Shkrimi i disa trajtave të shumësit të emrave dhe mbiemrave. - Përdorimi i nyjës së përparme, përshtatja dhe ndryshimet që ajo pëson në strukturat sintaksore. 	<p>Drejtshkrim dhe pikësim</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shkruan dhe përdor drejt: <ul style="list-style-type: none"> ∫ emrat dhe mbiemrat e njerëzve dhe pseudonimet e tyre; ∫ emrat e përveçëm që përdoren për të shënuar një kategori të caktuar njerëzish; ∫ emrat e përveçëm të botës mitologjike e fetare, si dhe emrat përveçëm të personazheve të tregimeve popullore; ∫ emërtimet e planetëve, të yjësive e të trupave qiellorë; ∫ emërtimet e funksionet shtetërore,

<ul style="list-style-type: none"> - Drejtshkrimi i foljeve të parregullta. - Përdorimi i shenjave të pikësimit (presja, pikëpresja, dy pikat). 	<p>politike, të gradave etj., që janë bërë pjesë e pandarë e një emri të përveçëm etj.;</p> <ul style="list-style-type: none"> - shkruan dhe përdor drejt emrat dhe mbiemrat në numrin shumës; - shkruan dhe përdor drejt nyjën e përparme para emrave dhe mbiemrave; - shkruan dhe përdor drejt foljet e parregullta; - shkruan dhe përdor drejt shenjat e pikësimit (presja, pikëpresja, dy pikat).
<p>Vlerat dhe qëndrimet</p>	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - vlerëson pasurinë leksikore të gjuhës shqipe; - respekton diversitetin gjuhësor mes njerëzve; - shfaq shpirt krijues në përdorimin e gjuhës; - shmang fjalët e huaja të panevojshme gjatë komunikimit. - vlerëson punët e të tjerëve; - bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. 	

III. SQARIME PËR LLOJET E TEKSTEVE

Teksti është element i rëndësishëm i lëndës së gjuhës shqipe, pasi nëpërmjet tij nxënësit ndërtojnë dhe zhvillojnë kompetencat e lëndës dhe kompetencat kyçe. Teksti duhet të jetë në përputhje me zhvillimin emocional dhe intelektual të nxënësit. Vit pas viti, nxënësit njihen dhe studiojnë tekste, shkalla e vështirësisë të të cilave vjen duke u rritur. Kështu, p.sh., në klasën e dhjetë, nxënësit marrin njohuri të përgjithshme për llojet e teksteve dhe për funksionet dhe qëllimet e tyre. Në klasën e njëmbëdhjetë dhe në klasën e dymbëdhjetë, njohuritë për tekstet vijnë duke u zgjeruar, si dhe shtohen njohuri të reja për karakteristikat ose veçoritë e llojeve të teksteve (p.sh., karakteristikat e një kronike - tekst rrëfyës).

Në lëndën e gjuhës shqipe, nxënësit demonstrojnë njohuritë dhe shkathtësitë e tyre në tekste të ndryshme. Teksti letrar studiohet në mënyrë të thelluar në lëndën e letërsisë, ndërsa në lëndën e gjuhës shqipe përmenden karakteristikat kryesore të teksteve dhe shërbejnë për të bërë krahasime mes llojeve të teksteve, si p.sh., krahasohet një përshkrim letrar dhe një përshkrim joletrar, ose krahasohet një tregim me një rrëfim gojor.

Përgjatë tri viteve të arsimit të mesëm të lartë, nxënësit dëgjojnë, shkruajnë, lexojnë dhe flasin për lloje të ndryshme tekstesh. Kjo u jep mundësi atyre të kuptojnë (dëgjojnë dhe lexojnë) se si gjuha ndërton, formon, modelon përvoja nëpërmjet stilit, gjinive dhe kontekstit, si dhe të krijojnë përvojat e tyre nëpërmjet gjuhës.

Secili fragmentet ose tekst që do të punohet nga nxënësit, duhet të realizohet në jo më pak se **3 orë mësimi**.


IV. UDHËZIME METODOLOGJIKE

Programi i lëndës së gjuhës shqipe bazohet në parimin se të gjithë nxënësit kanë mundësi që të arrijnë rezultate të mira dhe të jenë të suksesshëm. Një nga çelësat kryesorë në suksesin e tyre është cilësia e mësimdhënies. Për një mësimdhënie cilësore, mësuesit duhet të respektojnë pikat e forta të nxënësve, të identifikojnë nevojat e tyre gjatë të nxënësve, të përcaktojnë saktë qëllimet e vlerësimit dhe të planifikojnë mirë orën e mësimin. Mësuesit duhet të informojnë nxënësit për rezultatet e të nxënësve, t'i ndihmojnë ata që të aktivizojnë njohuritë e mëparshme, të japin udhëzime të diferencuara sipas nevojave të tyre, t'i orientojnë kur punojnë në grupe, si dhe t'u mësojnë strategjitë e të nxënësve, në mënyrë që ata të ndërtojnë vetë njohuritë dhe dijet e tyre.

Metodat bashkëkohore të mësimdhënies i aftësojnë nxënësit të punojnë në grupe të vogla e të mëdha. Kjo lloj mësimdhënieje mundëson që nxënësit ta ndihmojnë njëri-tjetrin, si dhe krijojnë një mjedis të përshtatshëm për nxënësit që janë të tërhequr ose të druajtur. Studimet tregojnë se këta nxënës përparojnë më mirë në klasa që mbështetin ndërveprimin ose të nxënës bashkëpunues. Pjesë përbërëse e mësimin duhet të jetë edhe ngulitja te nxënësit e cilësive, të tilla si: gatishmëria dhe vendosmëria për të çuar një detyrë deri në fund, komunikimi i qartë dhe brenda rregullave të mirësjelljes, shpirti i iniciativës, dëshira për të marrë përgjegjësi etj.

Gjuha shqipe mësohet më mirë nëpërmjet situatave në të cilat paraqiten ide, çështje dhe diskutime që janë të rëndësishme dhe me interes për nxënësit. Nuk mund të diktohen metoda ose aktivitete mësimore. Mësuesit janë të lirë të përzgjedhin ato metoda, teknika ose aktivitete që përkojnë me nivelin e nxënësve dhe që funksionojnë mirë në klasën e tyre. Megjithatë, mësuesit duhet të largohen nga mësimdhënia tradicionale, e cila e vë atë kryesisht në rolin e lektorit. Praktikën mësimore bashkëkohore dëshmojnë se stimujt (shpjegimi i mësuesit) me të cilat ndeshen nxënësit, asnjëherë nuk janë të mjaftueshme për të përfutur njohuri dhe dije. Të nxënës nuk është një dukuri stimul - përgjigje. Njeriu gjithmonë ka bërë përpjekje për të ndërtuar dhe për të rindërtuar kuptimin e dukurive nga jeta reale, për t'i bërë të kuptimshme ato. Në këtë mënyrë duhet të organizohet edhe procesi mësimor. Nxënësit duhet t'i ndërtojnë vetë njohuritë e tyre. Mësuesit duhet të krijojnë situata të nxënësve, në të cilat nxënësit ndërveprojnë me të tjerët dhe arrijnë të mësojnë duke bërë. Në këtë rast, ata e kanë më të lehtë edhe transferimin e këtyre njohurive ose shkathtësive në situata të reja dhe të panjohura më parë. Njëkohësisht, kjo filozofi të nxënësve i aftëson nxënësit të mendojnë në mënyrë kritike dhe krijuese. Në diagramin e mëposhtëm është pasqyruar një situatë e thjeshtë të nxënësve, e cila “kontribuon” në zhvillimin e disa kompetencave kyçe dhe të kompetencave të lëndës, në lidhjen ndër-lëndore etj.

Situatë të nxëni



V. VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënësit përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Ai mat shkallën në të cilën kompetencat janë arritur nga nxënësi. Vlerësimi i nxënësit nuk ka për qëllim vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj. Vlerësimi mbështetet tërësisht në rezultatet e të nxënësit të programit lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato njohuri që nuk përshkruhen në program. Objektivi i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe shkathtësitë, por edhe qëndrimet dhe vlerat e nxënësve, si qëndrimet etiko-sociale, në përgjithësi, dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti. Mësuesi zhvillon vetë dhe ndihmon nxënësit të zhvillojnë një larmi mënyrash vlerësimi.

Disa nga mënyrat e vlerësimit në lëndën e gjuhës shqipe janë:

- **Diskutim mbi tema të ndryshme (gjithnjë e më komplekse):** kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënësin të kuptojë përmbajtjen dhe të zgjerojë informacionet e tij. Ky vlerësim bën të mundur që mësuesi të vlerësojë nxënësit për mënyrën se si diskutojnë dhe ndërveprojnë me të tjerët, si dhe për nivelin e zbatimit të njohurive në jetën e përditshme.
- **Prezantimi me gojë:** kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënësin që të përzgjedhë dhe të sintetizojë materialet e ndryshme, të krijojë ose të mbajë qëndrim, si dhe të zhvillojë shkathtësitë e të folurit në publik.
- **Dëgjimi i një teksti:** kjo mënyrë vlerësimi i ndihmon nxënësit të zhvillojnë shkathtësitë e tyre për të dëgjuar, për të kuptuar atë që dëgjojnë, si dhe për të gjykuar në mënyrë kritike.
- **Shkrimi i teksteve përshkruese, rrëfyese, udhëzuese, argumentuese dhe informuese-paraqitëse:** kjo mënyrë vlerësimi i ndihmon nxënësit që të kërkojnë, të planifikojnë, të organizojnë dhe të redaktojnë shkrimet e tyre. Në vlerësimin e shkrimeve, mësuesi duhet ta ndjekë nxënësin gjatë gjithë hapave të procesit të të shkruarit dhe të vlerësojë se si nxënësi i zbaton ato. Procesi i të shkruarit është po aq i rëndësishëm sa produkti.
- **Lexime dhe studime tekstesh të llojeve të ndryshme:** kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënësin të zhvillojë strategjitë e të lexuarit dhe të reflektojë ndaj tekstit. Gjithashtu, kjo mënyrë vlerësimi bën të mundur që mësuesi të vlerësojë strategjitë e të lexuarit që përdor nxënësi për të përftuar kuptimin e tekstit, si dhe aftësitë e tij për të analizuar, për të sintetizuar dhe për të gjykuar për tekstin.

- **Zhvillimi i një projekti:** kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënësit që të bashkëpunojnë me të tjerët, të hulumtojnë në burime të ndryshme informacioni, të lidhin njohuritë me jetën reale, si dhe të prezantojnë në mjedise publike.
- **Testime:** kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënësin të përsërisë dhe të sintetizojë njohuritë e tij lëndore. Mësuesi planifikon testime me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore që përbëhen nga një a disa kapituj.
- **Punime ushtrimesh:** kjo mënyrë vlerësimi i ndihmon nxënësit të zbatojnë në praktikë njohuritë gjuhësore.
- **Portofoli i nxënësit,** si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë një periudhe kohore, në një lëndë të caktuar. Ai mund të përmbajë punë me shkrim, projekte kurrikulare, ese të llojeve të ndryshme etj. Ai i përngjet një albumi me anën e të cilit mësuesi, nxënësi vetë dhe prindërit e tij gjejnë informacion të shpejtë dhe të përmbledhur rreth progresit të nxënësit. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, ndërsa mësuesi rekomandon.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënësi vlerësohet me notë, ndërsa demonstroi arritjet e tij me gojë, me shkrim ose nëpërmjet veprimtarive a produkteve të tjera, si: shkruan, lexon, vlerëson, zbaton, analizon etj. Në punime të nxënësve me grupe, mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënës në veçanti.

Mësuesi nuk është i detyruar të vlerësojë me notë nxënësit në çdo orë mësimore dhe të vendosë nota për secilën orë mësimore. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë si partnerë rreth përvetësimit të njohurive të fituara në orët e kaluara dhe rreth përmbushjes së detyrave jashtë klase. Herë pas here, mësuesi duhet të vlerësojë me notë duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

VI. MATERIALET DHE BURIMET MËSIMORE

Për arritjen e kompetencave në lëndën e gjuhës shqipe është me rëndësi përdorimi i mjeteve dhe i materialeve mësimore, të cilat krijojnë mundësi që nxënësit të ndërtojnë dijet e tyre, t'i konkretizojnë njohuritë e tyre, të nxënë në mënyrë të pavarur, t'i përdorin dijet në jetën praktike dhe në kontekste të reja, të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik e krijues, të bashkëveprojnë me shokët e shoqet e klasës. Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë: tekstet shkollore, revistat, atlaset, enciklopeditë, antologjitë, televizori, projektori, videokasetat, kompjuteri, interneti, CD-të, radioja, DVD-të, magnetofoni etj.

Sugjerime për përdorimin e TIK-ut:

- Përdorimi i postës elektronike për shkëmbim informacioni.
- Përdorimi i internetit për të shfrytëzuar faqet e *web*-it të rekomanduara nga mësuesi.
- Përdorimi i CD-ROM për ruajtjen e informacionit të dëshiruar.